



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**Qeveria - Vlada – Government**

**Ministria e Ekonomisë**  
**Ministarstvo Ekonomije**  
**Ministry of Economy**

# **Raporti i Progresit**

**Për Vitin 2023 i**  
**Zbatimit të Strategjisë Minerare, për**  
**periudhën 2012-2025**

**Prishtinë,**

**2024**

## PËRMBAJTJA

---

I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE.....	3
I.1. Qëllimet Strategjike të Dokumentit.....	4
II. PROGRESI NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE TË DOKUMENTEVE STRATEGJIKE.....	4
II.1. PROGRESI KUNDREJT OBJEKTIVIT: .....	5
III. TREGUESIT KRYESORË TË NDIKIMIT TË MASAVE PËR ARRITJEN E OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE.....	15
IV. RREZIQET DHE HAPAT PËR ADRESIMIN E TYRE.....	17
V. SHTOJCA 1- PJESA MATRICORE E RAPORTIT TË PROGRESIT PËR VITIN 2023, TE STRATEGJIA MINERARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PERIUDHËN 2012-2025.....	20

## **I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE**

Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës për periudhën 2012-2025 përbën kornizën themelore, në bazë të së cilës përcaktohen objektivat dhe prioritetet zhvillimore të sektorit mineral. Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës për periudhën 2012-2025, përcakton politikat dhe masat për zhvillimin e sektorit mineral në dobi të zhvillimit ekonomik dhe të mirëqenies sociale.

Monitorimi i realizimit të Strategjisë Minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2012-2025, bëhet përmes Raportit Vjetor të Progresit.

Ky raport identifikon progresin e realizuar dhe identifikon sfidat për mosrealizimin e projekteve/aktiviteteve të caktuara. Rrjedhimisht, Raporti Vjetor i Progresit shërben edhe si bazë për rishikimin e politikave zhvillimore minerare, që do të mund të reflektoheshin në rishikimin e Strategjisë Minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2012-2025.

Raporti i Progresit për vitin 2023, është përgatitur sipas kërkesave të Udhëzimit Administrativ (UA) 07/18 për Planifikimin, Hartimin dhe Monitorimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimet dhe është në përputhje me nenin 73, të Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet si dhe nenit 44, paragrafët 5, 6, 7 dhe 8, të Ligjit Nr. 04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet dhe kapitullin 8, paragrafi 8.1 dhe 8.2 të Strategjisë Minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2012-2025.

Raporti i Progresit përshkruan progresin e realizimit të projekteve, gjegjësisht aktiviteteve me të dhënat nga institucionet dhe ndërmarrjet minerare për vitin 2023 në kuadër të Zbatimit të Strategjisë Minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2012-2025.

Identifikimi i sfidave do të ndihmojë në lehtësimin e punës në adresimin e çështjeve të cilat mund të konsiderohen si pengesë për zhvillimin e mëtutjeshëm të sektorit, dhe kjo do të ndihmojë drejtë përmirësimit të planifikimit, realizimit dhe analizimit më të thukët sa i përket planifikimit të kostos dhe kohës së realizimit të projekteve.

Ministria e Ekonomisë (ME), Departamenti i Minierave (DM) ka koordinuar procesin e hartimit të Raportit të Progresit për vitin 2023, ndërsa në hartimin e këtij dokumenti janë shërbyer me të dhëna nga institucionet relevante dhe ndërmarrjet kryesore të sektorit mineral siç janë: ME, KPMM, KEK ShA dhe "TREPÇA" ShA.

Fillimisht, Departamenti i Minierave (DM) ka hartuar modelin e raportimit përmes tabelave, ku janë paraqitur projektet e parapara për vitin 2023. Modeli i monitorimit dhe raportimit është bërë përmes tabelave me emërtimet e projekteve /aktiviteteve të planifikuara për tu realizuar gjatë viteve të fundit. Në tabela janë identifikuar objektivat dhe veprimet, afati i fundit, burimi i financimit, institucioni udhëheqës dhe mbështetës, produkti (Output), referenca në dokumente p.sh. Plani i Punës së Qeverisë (PPQ), Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) dhe progresi në zbatim.

## **1.1.Qëllimet Strategjike të Dokumentit**

Zhvillimi i qëndrueshëm dhe në harmoni me mjedisin e sektorit minerar është i rregulluar me Strategjinë Minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2012-2025, që bazohet në katër (4) shtylla themelore që në Raportin e Progresit do të identifikohen si qëllime apo objektiva strategjike të dokumentit.

Qëllimet strategjike në këtë dokument janë të identifikuar si në vijim:

**Qëllimi/Objektivi Strategjik:** Krijimi i kushteve të favorshme për shfrytëzim dhe valorizim ekonomik të resurseve minerale dhe tërheqje të investimeve;

**Qëllimi/Objektivi Strategjik/:** Rritja e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale në sektorin minerar;

**Qëllimi/Objektivi Strategjik:** Çështjet sociale dhe përfitimet e komunitetit;

**Qëllimi/Objektivi Strategjik :** Përkujdesja për mjedisin.

Realizimi i Qëllimeve/Objektive Strategjik të dokumentit strategjik, synon zbatimin e reformave kyçe në këtë sektor duke plotësuar në përpikëri kërkesat që kërkohen nga synimet dhe qëllimet strategjike. Me këtë qëllim në vitin 2023 janë realizuar njëzetë (20) projekte/aktivitete, prej të cilave disa janë zbatuar plotësisht dhe disa pjesërisht të cilat janë përshkruar në Shtojcën një (1) si më poshtë.

## **II. PROGRESI NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE TË DOKUMENTEVE STRATEGJIKE**

Zbatimi i masave të përcaktuara në Strategjinë Minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2012-2025, ka pasur ndikim të kënaqshëm në performancën e sektorit të minierave qoftë në rritjen e kapaciteteve prodhuese, ngritjen e kapaciteteve të reja dhe bashkëkohore operuese, duke ndikuar në rritjen e performancës, së përgjithshme, krahas kësaj ka pasur plotësim të kornizës ligjore me akte të nevojshme nënligjore, si dhe rritje të kapaciteteve institucionale për zbatimin e politikave në sektorin e minierave.

Në kuadër të monitorimit të zbatimit të Strategjisë Minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2012-2025, Ministria e Ekonomisë (ME), respektivisht Departamenti i Minierave (DM) ka koordinuar procesin e hartimit të Raportit të Progresit, ndërsa në hartimin e këtij dokumenti kanë marrë inputet dhe janë identifikuar rreziqet për të cilat do të adresohen në vitet e ardhshme me masa konkrete. Si pjesë e kësaj do të vazhdoj bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet relevante dhe ndërmarrjet kryesore të sektorit minerar në adresimin e të gjitha rreziqeve me të cilat vazhdojnë të ballafaqohen.

## **II.1. PROGRESI KUNDREJT OBJEKTIVIT**

Mund të konstatohet se ngecjet në realizimin e disa projekteve të parapara, tregon për domosdoshmërinë e marrjes së hapave konkret në eliminimin e barrierave që pengojnë zhvillimin e këtij sektori. Roli i institucioneve përgjegjëse të sektorit mineral, por edhe i ndërmarrjeve minerare në planifikimin e aktiviteteve dhe projekteve është jetik në suksesin dhe zhvillimin e sektorit mineral.

Në këtë drejtim duhet forcuar kapacitete institucionale përmes ngritjeve profesionale dhe investimeve në zhvillimin e teknologjisë. Po ashtu në suksesin e sektorit rol të rëndësishëm luan transparenca dhe lehtësimi i proceduarve burokratike. Në këtë drejtim duhet krijuar mundësitë institucionale që investitorët të kenë qasje të lehtë dhe të shpejt në interesat e tyre për investime duke pasur një adresë të qartë ku mund të drejtojnë kërkesat e tyre. Harmonizimi i ligjeve dhe heqja e paqartësive ligjore, bashkëpunimi me i ngushtë dhe i vazhdueshëm, hulumtimi i mundësive të reja për donacione dhe tërheqje të fondeve janë disa nga hapat e domosdoshme që duhet të ndërmerren në vitet në vazhdim në këtë drejtim.

### **Realizimi i prodhimit të lëndëve minerale**

Duhet theksuar se e veçanta e mineraleve si produkte ekonomike është në kompleksitetin e ekonomisë së lëndëve minerale dhe biznesin e minierave (Vogely, 1985; Strauss, 1986). Mineralet janë të shpërndara në mënyrë të pabarabartë dhe ndryshe nga produktet bujqësore apo pyjore, nuk mund të riprodhohen ose të zëvendësohen. Prandaj, një vendburim i mineraleve mund të konsiderohet si një aset shterues, prodhimi i të cilit është i kufizuar në zonën në të cilën ai ndodhet. Këta faktorë vendosin kufizime në një ndërmarrje minerare në fushat e praktikave të biznesit, financimit dhe praktikave të prodhimit. Për shkak se asetet minerale vazhdimisht shkojnë duke u shterur, ndërmarrjet minerare ose duhet të zbulojnë rezerva shtesë ose t'i kërkojnë ato duke i blerë për të qëndruar në biznesin e sektorit mineral.

Në vitin 2023, sikurse edhe në vitet paraprake, shumica e ndërmarrjeve që merren me shfrytëzimin e gurit të fortë, rërës dhe zhavorrit nuk po arrijnë të përmbushin planifikimet e tyre të prodhimit. Në bazë të analizave të bëra mund të konstatohet se arsyet kryesore për dështim të këtyre ndërmarrjeve janë si në vijim:

- Planifikimi joreal i ndërmarrjeve lidhur me shfrytëzimin dhe përpunimin e lëndës minerale;
- Mungesa e kapitalit të ndërmarrjeve për të investuar në fazën e hulumtimit për të evituar dështimin në fazat e mëvonshme të shfrytëzimit për shkak të cilësisë së dobët të mineralit;
- Çmimi i lartë i energjisë po shkakton vështirësi të mëdha në aktivitetet e ndryshme minerare;
- Konkurrenca (jo gjithëherë e lirë) dhe tregu jo i qëndrueshëm për këto produkte;
- Aktivitetet minerare të jashtëligjshme, etj.

### **2.4. Analizë e problemeve në sektorin mineral**

Sa i përket problemeve në sektorin e industrisë minerare vlen të theksohet se shfrytëzimi i lëndëve minerale është një sfidë e cila përcillet me shumë probleme qofshin ato njerëzore, organizative, pajisjet e amortizuara, rritja e çmimit të energjisë, të kapitalit investues, menaxhimit jo të duhur etj. Përveç këtyre, viti 2023 është përcjell edhe nga ngjarje të rëndësishme në arenën

ndërkombëtare (luftëra të ndryshme, vështirësi ekonomike-inflacioni, ndikimet e ndryshimeve klimatike etj.), të cilat në disa aspekte nuk kanë shkuar në favor të industrisë minerar.

Ndërmarrja energjetike Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), e cila shfrytëzon lëndën minerale energjetike - lignit, edhe këtë vit ka kaluar kryesisht mirë me aktivitetet e shfrytëzimit dhe sipas raportimeve nuk ka pasur probleme të theksuara që kishin me pengu shfrytëzimin e minierës.

Ndërmarrja “Trepça” ShA, do të hapë perspektiven e zhvillimit të saj duke rritur kapacitetet e prodhimit dhe realizimin e një produktiviteti më të lartë. Përkundër angazhimeve kjo ndërmarrje ende ballafaqohet me disa vështirësi të së kaluarës si: mosha e vjetër e minatorëve, pajisjet e vjetruara, etj.

Ndërmarrja “Newco Ferronikeli Complex L.L.C.” në vitin 2023, sipas raportimeve nuk ka shfrytëzuar lëndë minerale por vlen të theksohet se kjo ndërmarrje ka importuar lëndë minerale nga vendet jashtë Kosovës. Ndërmarrja në fjalë nuk ka mundur ta bëjë bartjen e kontrollit për shkak se bordi i KPMM-së, nuk ishte funksional, përkundër se “Yildirim Kosovo Mining Investment L.L.C.” ka blerë aksionet nga ndërmarrja “NKL Limited”, e cila kishte në pronësi gjegjësisht në menaxhim “Newco Ferronikeli Complex L.L.C.”.

Shfrytëzimi i mineraleve jometalore gjithashtu ka vështirësi nga më të ndryshmet të cilat e pengojnë mbarëvajtjen e aktivitetit minerar. Tregu i paqëndrueshëm për lëndët minerale, konkurrenca edhe për shkak të shumë operatorëve, krijojnë te ndërmarrjet probleme të tilla financiare të cilat me shumë vështirësi i përballojnë.

Nga sa u tha më lartë, mund të konstatojmë se, si rezultat i këtyre problemeve ndërmarrjet nuk i kanë realizuar planifikimet e tyre të prodhimtarisë në shfrytëzimin e lëndëve minerale për të cilat kanë poseduar licenca të shfrytëzimit. Planifikimi i prodhimtarisë vjetore nga ana e ndërmarrjeve deri tani asnjëherë nuk po është real dhe kjo po pamundëson shfrytëzimin e të dhënave të tilla për projekt-planin njëvjeçar (1) e menaxhimit të resurseve minerale. Vlen të theksohet se këtë vit ndërmarrjet kanë filluar me raportimin e *planifikimeve më reale* të shfrytëzimit të lëndës minerale për vitin vijues dhe shpresojmë që shumë shpejt do të gjendemi në një pozitë shumë më reale të planifikimeve.

## **2.5. Analizë e realizimit të prodhimtarisë së lëndëve minerale**

Analizimi i planifikimit për vitin vijues është bërë duke e marr parasysh trendin e shfrytëzimit të tri (3) viteve paraprake për vitet 2020-2023. Deri në kohën e bërjes së Projekt-Planit për Menaxhimin e Resurseve Minerale (fundi i vitit 2023), ndërmarrjet sjellin raportimet për tremujorët (3): TM<sub>1</sub>, TM<sub>2</sub> dhe TM<sub>3</sub> të vitit 2023. Nga këta tremujor (3) është nxjerrë e mesmja matematikore për TM<sub>4</sub>, dhe më pastaj në planifikim për vitin 2024 kemi marr parasysh edhe vitin 2023 si të kompletuar.

Duke u bazuar në atë çfarë u tha më lartë, për të pasur një planifikim të përafërt për vitin vijues është shfrytëzuar forma e grafikut e emërtuar si “*Mesatarja e lëvizshme e shfrytëzimit*”, i cili grafik mundëson që planifikimi për vitin vijues për lëndë të veçanta minerale të jetë shumë i përafërt dhe paraqet gjendjen më reale të mundshme.

### 2.5.1. Realizimi i prodhimit për lëndë minerale energjetike

Qymyri (linjiti) si mineral energjetik është resursi më i rëndësishëm i Republikës së Kosovës, ngase furnizimi më energji elektrike pothuajse tërësisht varet nga kjo lëndë minerale. Resurset e vlerësuara të qymyrit në gjithë Republikën e Kosovës janë rreth 12.5 miliardë tonë, që nga aspekti ekonomik konsiderohen me leverdi për tu shfrytëzuar. Aktualisht pranë KPMM-së, për shfrytëzimin e lëndëve minerale energjetike është e licencuar vetëm Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), e cila bënë shfrytëzimin sipërfaqësor të linjtit për nevojat e prodhimit të energjisë elektrike të vendit. Në vijim është paraqitur tabela me diagramet e shfrytëzimit të qymyrit (linjit) për vitet 2020-2023.

Lënda minerale	Aktiviteti	2020	Raporti Planifikim -	2021	Raporti Planifikim -	2022	Raporti Planifikim -	2023	Raporti Planifikim -
Lignit (t)	Rezervat e shfrytëzueshm	142,189,283.00	94.87	133,653,848.00	94.84	127,463,822.00	91.70	164,024,902.60	84.40
	Planifikimi	9,000,000.00		9,000,000.00		9,000,000.00		8,310,000.00	
	Rezervat e shfrytëzuara	8,537,948.00		8,535,435.00		8,253,368.00		7,013,624.06	

Tab.7. Gjendja e rezervave të mineraleve energjetike për vitet 2020-2023




Fig.12. Diagrami i gjendjes së rezervave minerale energjetike të planifikuara dhe shfrytëzuara për vitet 2020-2023.

### 2.5.2. Realizimi i prodhimit për lëndë minerale metalore

Shfrytëzimi i lëndëve minerale metalore edhe këtë vit sikurse vitet paraprake nuk ka shkuar sipas planifikimeve të parapara nga ndërmarrjet për shumë arsye disa nga të cilat janë përmendur më lartë të analiza e sektorit minerar.

Tab.8. Gjendja e rezervave minerale metalore për vitet 2020-2023

Tabela e gjendjes së rezervave minerale metalore për vitet 2020-2023									
Lënda mineral e	Aktivitetit	2020	Raporti Planifikim - Shfrytëzim	2021	Raporti Planifikim - Shfrytëzim	2022	Raporti Planifikim - Shfrytëzim	2023	Raporti Planifikim - Shfrytëzim
Pb-Zn	Rezervat e shfrytëzueshme	9,466,096.30	66.88	9,204,202.30	83.80	10,266,353.30	61.95	14,118,072.44	77.27
	Planifikimi	312,520.00		312,520.00		353,720.00		335,970.04	
	Rezervat e shfrytëzuara	209,017.00		261,894.00		219,118.67		259,618.04	
Ni-Co	Rezervat e shfrytëzueshme	19,805,192.77	46.61	19,349,950.77	52.60	19,315,665.16	4.69	19,315,665.16	0.00
	Planifikimi	816,468.00		865,506.30		918,183.60		470,870.00	
	Rezervat e shfrytëzuara	380,590.31		455,242.00		43,054.19		0.00	
Cr2O3	Rezervat e shfrytëzueshme	249,664.80	634.47	233,009.18	432.61	0.00	0.00	233,009.18	0.00
	Planifikimi	3,850.00		3,850.00		0.00		60,000.00	
	Rezervat e shfrytëzuara	24,427.00		16,655.62		0.00		0.00	




Fig.14. Diagrami i gjendjes së rezervave minerale metalore të planifikuar dhe shfrytëzuara për vitet 2020-2023

### 2.5.3. Realizimi i prodhimit për lëndë minerale jometalore

Në tabelat dhe grafikët e më poshtëme është paraqitur sasia e shfrytëzuar sipas lëndëve minerale jometalore. Përqindja (%) e realizimit të prodhimitarisë është bazuar në raportin në mes të planifikimit dhe realizimit sipas raportimit të ndërmarrjeve.

Siç shihet nga tabela nr. 9, gjendja e rezervave të mineraleve jometalore për periudhën 2020-2023, vërehet se, në vitin 2023 kemi rritje të shfrytëzimit të disa lëndëve minerale jometalore ndërsa kemi rënie në disa lëndë minerale varësisht nga kërkesat e tregut gjë që është normale dhe se kjo ndodhë pothuajse çdo vit. Një çështje e cila vlen të theksohet është fakti se në këtë vit bordi i



KPMM-së, ishte jofunksional dhe se disa ndërmarrje nuk kanë mundur të vazhdojnë licencat e skaduara apo të bëjnë zgjerimin e licencës së shfrytëzimit.

Tab.9. Gjendja e rezervave të mineraleve jometalore për vitet 2020-2023

Tabela e gjendjes së rezervave minerale jometalore për vitet 2020-2023									
Lënda minerale	Aktiviteti	2020	Raporti Planifikim - Shfrytëzim	2021	Raporti Planifikim - Shfrytëzim	2022	Raporti Planifikim -	2023	Raporti Planifikim - Shfrytëzim
Andezite (m3)	Rezervat e shfrytëzueshme	9,379,178.09	23.66	9,228,987.04	40.95	9,508,261.50	21.69	9,374,128.39	39.53
	Planifikimi	466,800.00		366,800.00		346,200.00		425,400.00	
	Rezervat e shfrytëzuara	110,461.16		150,191.05		75,119.39		168,194.38	
Argjillë (t)	Rezervat e shfrytëzueshme	13,654,474.54	50.34	12,084,277.58	56.65	12,658,558.67	47.22	8,628,838.88	40.84
	Planifikimi	1,020,410.00		900,510.00		691,710.00		300,500.00	
	Rezervat e shfrytëzuara	513,691.32		483,121.20		326,608.72		122,732.00	
Gëlqeror (m3)	Rezervat e shfrytëzueshme	242,841,810.85	45.93	236,476,753.19	59.63	239,284,058.97	38.44	222,830,475.31	66.00
	Planifikimi	12,673,659.80		11,362,057.80		11,297,443.80		8,889,233.20	
	Rezervat e shfrytëzuara	5,820,451.38		6,774,974.77		4,343,017.09		5,867,098.37	
Bazalt (m3)	Rezervat e shfrytëzueshme	1,348,052.37	206.35	1,307,729.68	213.35	1,286,987.39	146.33	1,268,725.59	96.62
	Planifikimi	18,900.00		18,900.00		18,900.00		18,900.00	
	Rezervat e shfrytëzuara	39,000.58		40,322.69		27,656.39		18,261.80	
Rërë dhe zhavorr (m3)	Rezervat e shfrytëzueshme	1,697,721.02	34.56	1,585,510.10	71.21	1,635,309.73	45.19	1,524,599.80	37.24
	Planifikimi	242,048.00		195,186.00		85,743.00		65,000.00	
	Rezervat e shfrytëzuara	83,640.04		138,985.93		38,743.73		24,208.00	
Rërë kuarcore (m3)	Rezervat e shfrytëzueshme	2,122,822.21	19.60	2,089,763.99	61.79	2,053,813.99	108.94	2,052,113.99	0.00
	Planifikimi	89,000.00		53,500.00		44,000.00		26,000.00	
	Rezervat e shfrytëzuara	17,442.35		33,058.22		47,933.33		0.00	
Mërgel (m3)	Rezervat e shfrytëzueshme	73,377,238.35	7.94	73,195,218.03	7.12	73,406,374.29	5.37	73,266,297.29	6.32
	Planifikimi	2,851,066.50		2,555,500.00		2,167,500.00		2,119,500.00	
	Rezervat e shfrytëzuara	226,325.00		182,020.32		116,391.32		134,040.00	
Diabaz (m3)	Rezervat e shfrytëzueshme	348,736.00	0.00	329,258.96	35.16	326,541.96	6.54	324,211.96	8.40
	Planifikimi	55,400.00		55,400.00		55,400.00		30,000.00	
	Rezervat e shfrytëzuara	0.00		19,477.04		3,622.67		2,520.00	
Mermer (m3)	Rezervat e shfrytëzueshme	7,632,992.25	0.03	8,366,389.00	0.33	8,364,079.00	1.22	1,243,897.55	0.00
	Planifikimi	209,400.00		252,150.00		252,150.00		12,000.00	
	Rezervat e shfrytëzuara	55.00		823.65		3,080.00		0.00	
Tuf (t)	Rezervat e shfrytëzueshme	34,297.70	2.21	33,946.70	2.93	33,946.70	0.00	21,145.70	0.00
	Planifikimi	12,000.00		12,000.00		12,000.00		12,000.00	
	Rezervat e shfrytëzuara	0.00		351.00		0.00		0.00	




Fig.15. Diagrami i gjendjes së rezervave minerale jometalore për vitet 2020-2023, më prodhimitari më të vogël se 100,000m<sup>3</sup>




Fig.15(a). Diagrami i gjendjes së rezervave minerale jometalore për vitet 2020-2023, më prodhimitari më të vogël se 100,000m<sup>3</sup>




Fig.15(b). Diagrami i gjendjes së rezervave të gëlqerorit për vitet 2020-2023, më prodhimi më të madhe se 100,000m<sup>3</sup>




Fig.16. Diagrami i gjendjes së rezervave të lëndës minerale jometalore të planifikuara dhe shfrytëzuara për vitet 2020-2023, më prodhimi më të vogël se 100,000m<sup>3</sup>




Fig.16 (a). Diagrami i gjendjes së rezervave të lëndës minerale jometalore të planifikuara dhe shfrytëzuara për vitet 2020-2023, më prodhimi më të vogël se 100,000m<sup>3</sup>




Fig.16 (b). Diagrami i gjendjes së rezervave të gëlqerorit dhe mërgel-ës të planifikuara dhe shfrytëzuara për vitet 2020-2023, më prodhimi më të madhe se 100,000m<sup>3</sup>

### 2.5.4. Eksporti dhe importi i lëndëve minerale

Më poshtë në Tab.10. dhe Tab.11. janë paraqitur shënimet e pranuar nga Doganat e Republikës së Kosovës në lidhje me sasinë e lëndës minerale të eksportuar dhe importuar e të cilat kanë emërtime të ndryshme nga ato që ne i kemi në bazën e shënimeve. Nga këto të dhëna vërehet se në eksport mbizotërojnë xeherorët dhe koncentratet e plumbit, zinkut, kromit etj., ndërsa në import xeherorët dhe koncentratet e nikelit.

Tab.10 Sasia e lëndës minerale-koncentratit të eksportuar në periudhën 01.01.2023 deri më 19.12.2023 EX1-Eksporti i rregullt () - Të dhënat Komerciale sipas kodit tarifor (HS-10) / 2023-01-01 deri 2023-12-19/

		Neto Kg	Vlera
2023	EX1 2601200000 - Pirit i pjekur i hekurit	5,386,510.00	117,485.92
	2604000000 - Xeherore dhe koncentrate nikel	23,780.00	627.79
	2606000000 - Xeherore dhe koncentrate alumini	261,730.00	73,311.98
	2607000000 - Xeherore dhe koncentrate plumbi	6,790,943.00	11,094,755.71
	2608000000 - Xeherore dhe koncentrate zinku	18,766,349.48	6,090,913.71
	2610000000 - Xeherore dhe koncentrate kromi	1,333,558.00	299,372.46
	2617900000 - Të tjera	4,698.61	62.34
	2618000000 - Zgjyra të granuluara (rërë zgjyre) të dalë nga përpunimi i hekurit dhe çelikut	1,410,505.00	156,691.83
	2620110000 - Shufra të forta zinku	69,185.00	108,566.69
	2620300000 - Që përmbajnë kryesisht bakër	14,500.00	1,450.00
	<b>Total</b>	<b>34,061,759.09</b>	<b>17,943,238.43</b>

Tab.11 Sasia e lëndës minerale-koncentratit të importuar në periudhën 01.01.2023 deri më 19.12.2023 IM4-Importi i rregullt () - Të dhënat Komerciale sipas kodit tarifor (HS-10)/Prej: 2023-01-01 deri: 2023-12-19

		Neto Kg	Vlera
2023	IM4 2604000000 - Xeherore dhe koncentrate nikel	55,270,710.00	5,823,421.39
	2616900000 - Të tjera	4.50	2,164.95
	2620999500 - Të tjera	21.00	21.57
	2621900000 - Të tjera	924.44	308.51
	<b>Total</b>	<b>55,271,659.94</b>	<b>5,825,916.42</b>

## 2.6. Aktivitetet e jashtëligjshme

Aktiviteti i veprimtarisë së jashtëligjshme është një çështje sfiduese për KPMM-në. Në vitin 2023 janë marr aksione të përbashkëta të Inspektoratit të KPMM-së, me institucionet tjera të vendit si: MMPH-në, APK-në, Policinë e krimeve të rënda, Policinë lokale dhe Inspektoratet lokale më qëllim të parandalimit të kësaj dukurie të jashtëligjshme duke identifikuar dhe ndërmarrë masa ndëshkimore ligjore. Më poshtë në tabelën nr.14, janë paraqitur të dhënat për aktivitetet e jashtëligjshme minerare për vitin 2023.

Tab.12. Operimet ilegale sipas llojit të lëndës minerale

Operimet ilegale sipas llojit të lëndës minerale	Evidenca
Industriale	<b>0</b>
Guri të fortë	<b>14</b>
Rërë dhe zhavorr	<b>22</b>
Qymyr (linjit)	<b>0</b>
Fabrikë përpunimi të lëndës minerale/seperacion	<b>9</b>
Gjithsej:	<b>45</b>

Për të gjitha shfrytëzimet ilegale të resurseve janë ngritur kallëzime penale, janë dhënë gjoa administrative ndaj personave fizik gjegjësisht ndërmarrjeve për aktivitete të jashtëligjshme minerare dhe të aktiviteteve të veçanta, si dhe lëndë të caktuara kanë shkuar në procedurë përmbarimore. Si pasojë e aktiviteteve të jashtëligjshme minerare (shfrytëzimi i lëndëve të ndryshme minerale) përveç humbjeve në resurs po mbesin edhe degradime të mëdha dhe të rrezikshme mjedisore e veçanërisht përgjatë brigjeve të lumenjve, ku rehabilitimi i tyre do të ketë një kosto të lartë. Duhet theksuar se kjo veprimtari është në kundërshtim të plotë me konkurrencën e lirë dhe mbrojtjen e saj e cila paraqet një segment vital për ekzistimin e ekonomisë së të tregut (LIGJI Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës). Nga këto aktivitete të jashtëligjshme po pësojnë humbje financiare ndërmarrjet e licencuara të cilat i përmbushin të gjitha obligimet ligjore, Buxheti i Republikës së Kosovës (BRK), dhe po ashtu konsiderohen dëme financiare edhe përdorimi i materialeve jociësore në ndërtimin e infrastrukturës rrugore.

## 2.7. Aktivitetet e rikultivimit dhe mbylljes së minierave/guroreve në vitin 2023

Sipas informatave të marra nga inspektorati i KPMM-së, gjendja e rikultivimit dhe mbylljes së minierave/guroreve pas shqyrtimit të lëndëve për mbylljen e aktivitetit minerar është si në tabelën më poshtë.

Tab.13. Rikultivimi dhe mbyllja e minierave/guroreve

Rikultivim dhe mbyllje	Nr. i Licencave
Rikultivim me mbyllje	6

## **2.8. Realizimi i të hyrave nga renta minerare**

Në realizimin e të hyrave nga renta minerare në këtë vit në veçanti ndikim të madh kanë pasur ndërmarrjet siç janë: Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), “Sharr Cem” ShPK, si dhe shfrytëzimi i madh i shkëmbinjve të fortë nga ndërmarrjet e ndryshme, me qëllim të ngritjes së infrastrukturës rrugore, ndërtimore etj.

### **Ndikimi i sektorit minerar në çështjet sociale dhe ekonomike të vendit**

Sektori i mineraleve ndryshon nga industritë e tjera në atë se lokacioni i operimeve diktohet nga faktorë gjeologjikë, çka në fakt do të thotë se aktivitetet minerare nuk mund të zhvendosen në vende tjera ku operimet e tilla kishin me qenë me shpenzime më të ulëta. Anasjelltas, industria minerare ka potencialin për të krijuar mundësi të punësimeve afatgjata.

Ndërmarrjet e licencuara në KPMM, në raportimet vjetore janë të obliguara që të raportojnë dhe për numrin e të punësuarve. Numri i punëtorëve të angazhuar në dhe rreth aktiviteteve minerare është rreth 18,000 të punësuar. Pra mund të thuhet se përkundër gjendjes jo të volitshme në të cilën është sektori minerar nuk mund të mohohet ndikimi i tij në çështjet sociale dhe zhvillimin e shoqërisë.

Zhvillimi i minierave përveç ndikimit në punësim dhe çështje sociale të punëtorëve, ka ndikim dhe në buxhetin e shtetit me rreth 26,630,706.54€ rentë për shfrytëzimin e mineraleve (periudha nga janari deri më 18.12.2022), Aktiviteti minerar po ashtu ka ndikim indirekt në rritjen e buxhetit për rreth 150,000,000.00€ - 200,000,000.00€ në vit.

Kontribuesit më të mëdhenj të të hyrave sa i përket rentës minerale për këtë vit janë ndërmarrjet KEK-u dhe “Sharr Cem” ShPK.

- Nga KEK-u, gjatë vitit 2023 janë inkasuar 22,244,220.15 €
- Nga “Sharr Cem” ShPK gjatë vitit 2023 janë inkasuar 256,495.49 €

Është më rëndësi të ceket se nga minierat e “Trepçës” nuk kemi fare inkasim të rentës nga fillim i prodhimit deri me tani.

### **Ndikimi i aktiviteteve minerare në mjedis**

Mbrojtja dhe rehabilitimi i mjedisit gjatë hulumtimit, shfrytëzimit, pasurimit dhe përpunimit të resurseve minerale duhet t'i përmbahet legjislacionit në fuqi si: Ligji për Miniera Minerale Nr.03/-163 neni 74, respektivisht Ligjit Nr.04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit bazik, Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr.03/1-233 2010, Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060 2012, Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 03/L-214 2010, Ligjin për Mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102 2007, Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 2009, Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 03/L-160 2010.

Mjedisi ku zhvillohen aktivitetet minerare me tërë kompleksitetin që posedon gjithmonë tërheq vëmendjen e të gjitha institucioneve të vendit dhe angazhimi në këtë drejtim është i përhershëm. Gjatë vitit 2023 nuk ka pas ndonjë aksident të theksuar mjedisor si pasojë e aktiviteteve minerare.

Vlen të theksohet se flotacionet dhe fabrikat e përpunimit të agregateve duhet të investojnë edhe më tepër në evitimin e ndotjeve të cilat vijnë si rezultat i punës së tyre, pra më pak mbetje teknologjike të dëmshme dhe më pak pluhur për mjedisin ku veprojnë.

### **III. TREGUESIT KRYESORË TË NDIKIMIT TË MASAVE PËR ARRITJEN E OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE**

Zbatimi i masave të përcaktuara në Strategjinë Minerare të Republikën e Kosovës për periudhën 2012-2025, ka pasur ndikim të kënaqshëm në performancën e sektorit të minierave qoftë në rritjen e kapaciteteve prodhuese, ngritjen e kapaciteteve të reja dhe bashkëkohore operuese, duke ndikuar në rritjen e performancës së përgjithshme në krahasim me vitin 2022. Krahas kësaj ka pasur plotësim të kornizës ligjore me akte të nevojshme nënligjore si dhe rritje të kapaciteteve institucionale për zbatimin e politikave në sektorin e minierave. Në vitin 2023 më 15 qershor, Ligjin Nr.08/L-214 për plotësimin e Ligjin 04/L-158 për ndryshimin e Ligjit për Miniera dhe Minerale 03/L-163 i vitit 2013 (nenet 60-të Ligjit Bazik, paragrafi 3 dhe 4 fshihen nga teksti i ligjit).

Në vazhdim paraqiten disa nga treguesit kryesorë të ndikimit të masave të secilit objektiv strategjik.

#### **Objektivi Strategjik: Krijimi i Kushteve të Favorshme për Valorizimin Ekonomik të Resurseve Minerale dhe Tërheqjen e Investimeve**

Në zbatim të këtij objektiv, aktivitetet që janë kryer plotësisht janë treguesit kryesorë të ndikimit të masave duke konstatuar një realizim të kënaqshëm të objektivit. Masat e planifikuara për arritjen e objektivit të përcaktuara për vitin 2023, kanë ndikuar në krijimin e kushteve të favorshme për valorizimin ekonomik të resurseve minerale dhe tërheqjen e investimeve. Kjo është arritur përmes tregueseve si më poshtë:

- Rritja e investimeve të huaja direkt në sektorin minerar në dy pikë tetë përqind (2.8 %) investimet e huaja direkt në Kosovë - sipas aktivitetit ekonomik për periudhën 2008-2021, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) për vitin 2023;
- Rritja e sasisë së produkteve minerale të eksportuar për dy pikë dy përqind (2.2%) 103,969,000.00 euro. Eksporti sipas seksioneve Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) për vitin 2022;
- Rritja e sasisë së produkteve minerale të importuar për pesëmbëdhjetë pikë gjashtë përqind (15.6%) 1,045,490,000.00 euro. Importi sipas seksioneve Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) për vitin 2023.
- **Objektivi Strategjik: Rritja e Kapaciteteve Njerëzore dhe Institucionale në Fushën e Sektorit Minerar**

Në zbatim të këtij objektiv, aktivitetet që janë kryer plotësisht janë treguesit kryesorë të ndikimit të masave duke konstatuar një realizim jo të kënaqshëm të objektivit. Masat e planifikuara për arritjen e objektivit të përcaktuara për periudhën 2020-2023, kanë ndikuar në rritjen e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale në fushën e sektorit minerar. Kjo është arritur përmes tregueseve si më poshtë:

- Rritja e numrit të të aftësuarve në aspektin profesional në dyqind e dyzet (240) të aftësuar;
- Rritja e numrit të të diplomuarve në sektorin minerar në pesëmbëdhjetë (15). Raporti Vjetor i UIBM-së për vitin 2023;

- Numri i trajnimeve të realizuara në fushën minerare nga të cila kanë përfituar katërqind e tredhjet e dy (432) persona. Raporti Vjetor i KEK-ut, dhe KPMM-së;
- Rritja e kualitetit dhe besueshmërisë së të dhënave;
- Licencat aktive të shfrytëzimit sipas lëndëve minerale gjithsej njëqind e tridhjetë e gjashtë (136). Rritja e numrit të licencave për shfrytëzim për dymbëdhjetë përqind (12%) respektivisht njëmbëdhjetë përqind (11 %) licenca Raporti Vjetor i KPMM-së, më datë 13.12.2023;
- Aplikacione për licenca të hulumtimit të lëndëve minerale kanë qenë tridhjetë e pesë (35). Licencat aktive të hulumtimit të lëndëve minerale janë nëntëdhjet e tre (93), gjendja në datën 13.12.2023;
- Aplikacionet për aktivitete të veçanta gjatë vitit 2023 janë gjashtëdhjetë e shtatë (67), gjendja më datën 14.12.2023, rritje për njëqind e tridhjetë e dy përqind (132%). Lejet e aktiviteteve të veçanta gjithsej njëqind e pesëdhjet e gjashtë (156) leje për aktivitete të veçanta ku mbizotërojnë shtatëdhjetë (70) leje për sortues, gjashtëdhjetë e gjashtë (66) për baza të betonit dhe pesëmbëdhjetë (15) leje për bazat e asfaltit.

### **Objektivi Strategjik: Çështjet Sociale dhe Përfitimet e Komunitetit**

Në zbatim të këtij objektivi, aktivitete që janë kryer plotësisht janë treguesit kryesorë të ndikimit të masave duke konstatuar një realizim të kënaqshëm të objektivit. Kjo është arritur përmes tregueseve si më poshtë:

- Norma e punësimit në sektorin minerar në dy presje një përqind (2,1 %), shpërndarja e të punësuarve sipas sektorit ekonomik (xehetari dhe gurore) gjatë periudhës 2008-2020, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) për vitin 2022;
- Aplikimi i standardeve dhe rregullave të shëndetit dhe sigurisë në punë për pesëdhjetë përqind (50%);
- Rritja e investimeve dhe përfitimeve të komunitetit nga veprimtaria minerare. Viti 2023 pesë (5) milion euro, njëzetë përqind (20%) nga Rentat minerare.

### **Objektivi Strategjik: Përkujdesja për Mjedisin**

Në zbatim të këtij objektivi, aktivitete që janë kryer plotësisht janë treguesit kryesorë të ndikimit të masave duke konstatuar një realizim jo të kënaqshëm të objektivit. Kjo është arritur përmes tregueseve si më poshtë:

- Aplikimi i standardeve mjedisore në sektorin minerar për pesëdhjetë përqind (50 %);
- Adoptimi dhe zbatimi i standardeve mjedisore të BE-së, në sektorin minerar në pesëdhjetë përqind (50%);
- Reduktimi i sasisë së mbeturinave të gjeneruara dhe të rrezikshme nga aktivitetet minerare - xehetari dhe gurëthyes në 2.795.809 tonë. Sasia e mbeturinave të gjeneruara dhe të rrezikshme, nga kompanitë me dhjetë (10) ose më shumë punëtorë, anketës i janë përgjigjur shtatëqind e dyzet e pesë (745) biznese tetëdhjetë e tetë pikë pesë përqind (88.5%) periudhës kohore gusht -shtator 2023.
- Gjithsej sasia e mbeturinave të përpunuara ka qenë 3.390.096 tonë, krahasuar me vitin 2021 ka qenë pesëdhjetë e tre pikë dy përqind (53.2 %) më e lartë, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) për vitin 2023.



#### **IV. RREZIQET DHE HAPAT PËR ADRESIMIN E TYRE**

Rreziqet e hasura gjatë monitorimit të këtij dokumenti lidhen me kapacitetin institucional, kapacitetin financiar, mjedisin rregullator, partneritetin dhe angazhimin e institucioneve të tjera, si dhe faktorët e tjerë të jashtëm që ndikojnë në nivelin e zbatimit të dokumentit strategjik.

Rrezik më i zakonshëm në aktivitetet e tyre të përgjithshme të institucioneve, gjegjësisht ndërmarrjeve minerare, në drejtim të realizimit të projekteve të Programit për Zbatimin e Strategjisë Minerare (PZSM) për vitin 2023, bazuar në takimet dhe diskutimet e përbashkëta, vlerësohet të jetë mungesa e mjeteve financiare.

Në kuadër të monitorimit të zbatimit dhe Programit për Zbatimin e Strategjisë Minerare (PZSM) për periudhën 2022-2024, Ministria e Ekonomisë (ME), respektivisht Departamenti i Minierave (DM) ka koordinuar procesin e hartimit të Raportit të Progresit për vitin 2023, ndërsa, në hartimin e këtij dokumenti kanë marrë inputet dhe janë identifikuar rreziqet për të cilat do të adresohen në vitet e ardhshme me masa konkrete. Si pjesë e kësaj do të vazhdoj bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet relevante dhe ndërmarrjet kryesore të sektorit minerar në adresimin e të gjitha rreziqeve me të cilat vazhdojnë të ballafaqohen.

Mund të konstatohet se ngecjet në realizimin e disa projekteve të parapara, tregon për domosdoshmërinë e marrjes së hapave konkret në eliminimin e barrierave që pengojnë zhvillimin e këtij sektori. Roli i institucioneve përgjegjëse të sektorit minerar por edhe i ndërmarrjeve minerare në planifikimin e aktiviteteve dhe projekteve është jetik në suksesin dhe zhvillimin e sektorit minerar. Në këtë drejtim duhet forcuar kapacitetet institucionale përmes ngritjeve profesionale dhe investimeve në zhvillimin e teknologjisë. Po ashtu në suksesin e sektorit rol të rëndësishëm luan transparenca dhe lehtësimi i proceduarve burokratike. Në këtë drejtim duhet krijuar mundësit institucionale që investitorët të kenë qasje të lehtë dhe të shpejt në interesat e tyre për investime duke pasur një adresë të qartë ku mund të drejtojnë kërkesat e tyre. Harmonizimi i ligjeve dhe heqja e paqartësive ligjore, bashkëpunimi më i ngushtë dhe i vazhdueshëm, hulumtimi i mundësive të reja për donacione dhe tërheqje të fondeve janë disa nga hapat e domosdoshëm që duhet të ndërmerren në vitet në vazhdim në këtë drejtim.

#### **Sfidat, mangësitë dhe pengesat**

Sfidat, mangësitë dhe pengesat e hasura gjatë monitorimit të këtij dokumenti lidhen me kapacitetin institucional, kapacitetin financiar, mjedisin rregullator, partneritetin dhe angazhimin e institucioneve të tjera, si dhe faktorët e tjerë të jashtëm që ndikojnë në nivelin e zbatimit të dokumentit strategjik.

Sfida më e zakonshme në aktivitetet e tyre të përgjithshme të institucioneve, gjegjësisht ndërmarrjeve minerare, në drejtim të realizimit të Strategjisë Minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2012-2025, për vitin 2023, bazuar në takimet dhe diskutimet e përbashkëta, vlerësohet të jetë mungesa e mjeteve financiare.

Sfida tjera dhe mangësi tjera mund të quhen edhe performanca institucionale menaxhuese, aftësitë profesionale, procedurat burokratike të ndërlikuar me procedurat e ndërlikuara të pajisjes me licencë,

për zhvillimin e aktivitetit minerar (në kuptimin e përfshirjes të shumë institucioneve që sipas tyre shpeshherë kanë rënë në kundërshtim me njëra-tjetrën, për sa i përket interpretimeve të ligjeve që e rregullojnë fushën përkatëse).

Duke pasur parasysh të gjitha këto që u thanë dhe të dhënat e përshkruar në tabelat më lart mund të konstatohet se është shënuar një progres i kënaqshëm i disa institucioneve si indikator i përgjithshëm i Progresit të Zbatimit të Strategjisë Minerare (PZSM). Ngecjet në realizimin e disa projekteve të parapara, tregojnë për mangësitë në planifikimin e projekteve nga ana e ndërmarrjeve dhe institucioneve të sektorit minerar, por edhe në punën e institucioneve përgjegjëse në eliminimin e barrierave që pengojnë zhvillimin e këtij sektori.

### **Resurset buxhetore**

Pjesa më e madhe apo mbi nëntëdhjetë për qind (90%) e buxhetit që parashihen të shpenzohen në zbatimin e Strategjisë Minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2012-2025, është nga Ndërmarrjet Publike (NP) dhe private minerare. Vetëm një pjesë e vogël e kostos së zbatimit të Programit të Zbatimit të Strategjisë Minerare (PZSM), është mbuluar nga Buxheti i Republikës së Kosovës (BRK). Nga Buxheti i Republikës së Kosovës (BRK), kryesisht janë mbuluar projektet për Ndërmarrjet Publike (NP) si “Trepça” ShA, dhe projektet nga institucionet e sektorit minerar.

### **Konkluzionet dhe rekomandimet për hapat e ardhshëm**

Mund të thuhet se disa nga institucionet dhe ndërmarrjet minerare nuk kanë analizuar në mënyrë të mjaftueshme burimin e financimit të projekteve përkatëse, që më vonë ka rezultuar me mosrealizimin e projekteve të caktuara si pasojë e mungesës së mjeteve financiare.

Po ashtu vlen të theksohet performanca e Ndërmarrjeve Publike (NP) “Trepça” ShA dhe KEK ShA, që nuk kanë realizuar shumë projekte që i kanë parapara për realizim me mjete vetanake, dhe rrjedhimisht kanë treguar një performancë të dobët në progres, që edhe ka ndikuar në performancën e tyre të ulët të realizueshmërisë së Programit të Zbatimit të Strategjisë Minerare (PZSM) për vitin 2023.

Duke pasur parasysh të gjitha këto që u thanë dhe të dhënat e përshkruar në tabelat më lart mund të konstatohet se është shënuar një progres i kënaqshëm i disa institucioneve si indikator i përgjithshëm i Progresit të Zbatimit të Strategjisë Minerare (PZSM). Ngecjet në realizimin e disa projekteve të parapara, tregojnë për mangësitë në planifikimin e projekteve nga ana e ndërmarrjeve dhe institucioneve të sektorit minerar, por edhe në punën e institucioneve përgjegjëse në eliminimin e barrierave që pengojnë zhvillimin e këtij sektori.

Rekomandimet dhe hapat e ardhshëm bazuar edhe në shqetësimet e paraqitura nga kompanitë e sektorit minerar, janë të ndërlidhura me lehtësimin e procedurave të pajisjes me licencë, për zhvillimin e aktivitetit minerar në kuptimin e përfshirjes të shumë institucioneve që sipas tyre shpeshherë kanë rënë në kundërshtim me njëra - tjetrën, për sa i përket interpretimeve të ligjeve që e rregullojnë fushën përkatëse.

Disa nga rekomandimet dhe hapat e ardhshme janë:

- Krijimi dhe harmonizimi i bazës ligjore funksionale dhe standardeve të veprimtarisë minerare, që garanton mbrojtjen e mjedisit, shëndetit dhe sigurinë në punë, si dhe transparencën dhe llogaridhënien;
- Përmirësim të klimës së investimeve përmes krijimit të kushteve konkurruese ligjore dhe fiskale për të tërhequr dhe mbajtur investitorët e sektorit privat, tërheqjen e investitorëve të kualifikuar përmes një metodologjie të licencimit të përshtatshme;
- Rritja e transparencës në procedurat e tenderimit dhe të licencimit, nëpërmjet përdorimit të tenderimit elektronik;
- Përgatitja e një programi strategjik me objektiva afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata me prioritete duke adresuar çështjet mjedisore dhe sociale, nëpërmjet përgatitjes dhe zbatimit të një programi strategjik mjedisor dhe social;
- Përmirësim të produktivitetit dhe konkurrencës, përdorimit racional të burimeve financiare, njerëzore dhe natyrore;
- Rritje të investimeve në kapacitete institucionale dhe në hulumtime të reja gjeologjike;
- Përmirësim të organizimit të kompanive të vogla, minierave, monitorimin e praktikave të sigurisë dhe mbrojtjes së ambientit dhe nxitjen e inkurajimit dhe krijimit të kompanive të mesme e të mëdha minerare;
- Rivlerësim i resurseve minerale, mbledhjen e të dhënave themelore gjeologjike, shfrytëzimin e të dhënave (p.sh. incizimet ajrore gjeofizike etj.), që ndihmojnë në zbulimin e mineraleve dhe tërheqjen e kompanive për të investuar në veprimtaritë e hulumtimit dhe të shfrytëzimit;
- Zhvillim të bazës së të dhënave, GIS-it, dhe bashkëpunimin ndërinstitucional të sektorit minerar të kompanive të vendit dhe me ato homologe evropiane;
- Menaxhim me efikas dhe të sigurt të mbetjeve minerare dhe inkurajim të proceseve të riciklimit;
- Mbrojtja e resurseve minerale si një pasuri e vendit, nga ndërtimi i objekteve të ndryshme mbi resurse apo në afërsi të tyre në favor të shfrytëzimit racional të resurseve minerale në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit;
- Nxitja e hulumtimeve sidomos të mineraleve metalore duhet të jetë prioritet edhe në vitin vijues në mënyrë që të zgjerohet baza e rezervave të këtyre lëndëve;
- Zhvillimi i “Zonave me interes të veçantë mineral” duke krijuar mundësi për investime në këto zona;
- Të përcillet me kujdes nga KPMM-ja, planifikimi i ndërmarrjeve për shfrytëzimin e lëndës minerale që realizimi të jetë në kufijtë racional të planifikimit;
- Rritja e angazhimit të Inspektoratit të KPMM-së, dhe koordinimi me institucionet relevante për ndalimin dhe parandalimin e aktiviteteve të jashtëligjshme të shfrytëzimit të resurseve minerale;
- Të shqyrtohet mundësia e riciklimit të mbetjeve nga veprimtaria minerare, ndërtimet, rindërtimet, riparimit dhe shkatërrimet e ndërtesave apo konstruksioneve të tjera e që njihen si mbetje inerte (materialet si: gurë, beton, tjegulla, etj.);
- Të kihet parasysh vendimi i qeverisë për moratoriumin për gurthyesit e rinj dhe në procedurë për pëlqim mjedisor për periudhën dyvjeçare (2) qershor 2021 – qershor 2023 (të qartësohen hapat që duhet ndërmarr në zbatimin e këtij vendimi).

**V. SHTOJCA I- PJESA MATRICORE E RAPORTIT TË PROGRESIT PËR VITIN 2023, TË STRATEGJIA MINERARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PERIUdhËN 2012-2025**

Në këtë shtojcë jepen informata mbi statusin e zbatimit të veprimeve, bashkë me një përshkrim të shkurtër të progresit në çdo veprim/aktivitet, treguesit e produktit (Output), ndonjë problem të identifikuar dhe hapat e propozuar të ardhshëm.

<b>1. OBJEKTIVI STRATEGJIK: KRIJIMI I KUSHTEVE TË FAVORSHME PËR VALORIZIMIN EKONOMIK TË RESURSEVE MINERALE DHE TËRHEQJEN E INVESTIMEVE</b>							
<b>1.1 Objektivi specifik: Plotësimi i Infrastrukturës Ligjore dhe Rregullator</b>							
Nr.	Objektivat dhe veprimet	Afati i fundit	Burimi i financimit	Institucion i udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Referenca në dokumente (p.sh. PPQ, PKZMSA)	Progresi në zbatim
1	Udhëzim Administrativ (UA) për mënyrën e blerjes, dhurimit, trashëgimit, ndërrimit, ekspozimit të kristaleve dhe mineraleve, si dhe mënyrën e pajisjes me dokumentacion përkatës të koleksionuesit e mineraleve dhe kristaleve	2024	Pa kosto	ME ShGjK	Plotësimi i infrastrukturës ligjore, për shërbime nga ShGjK-ja.	Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës, për periudhën 2012-2025.	Draft Udhëzim Administrativ (UA), për mënyrën e blerjes, dhurimit, trashëgimit, ndërrimit, ekspozimit të kristaleve dhe mineraleve, si dhe mënyrën e pajisjes me dokumentacion përkatës të koleksionuesit e mineraleve dhe kristaleve, është zhvilluar, ka kaluar të gjitha fazat e konsultimit publik, dhe së shpejti pritet të dërgohet për nënshkrim te ministrja znj. Artane Rizvanolli.
2	Rregullore për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës (ShGjK).	2024	Pa kosto	ME ShGjK	Plotësimi i infrastrukturës ligjore, për shërbime nga ShGjK-ja.	Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës, për periudhën 2012-2025.	Rregullorja është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës (QRK) dhe është publikuar në Gazetën Zyrtare (GZ) më datë 31.03.2023.
<b>1.2 Objektivi specifik: Hartimi i politikave zhvillimore për sektorin minerar</b>							
Nr.	Objektivat dhe veprimet	Afati i fundit	Burimi i financimit	Institucion i udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Referenca në dokumente (p.sh. PPQ, PKZMSA).	Progresi në zbatim

1.2.1	Plani për Menaxhimin e Resurseve Minerale.	2024	Pa kosto	ME, KPMM	Plani për Menaxhimin e Resurseve Minerale për vitin 2023 i miratuar.	Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës, për periudhën 2012-2025.	Realizimi: njëqind përqind (100 %). Plani i Menaxhimit të Resurseve Minerale për vitin 2023 është miratuar nga ME-ja. Sipas Ligjit për Miniera dhe Minerale (LMM) Nr.03/-163 neni 74, respektivisht Ligjit Nr.04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit bazik neni 45, KPMM-ja, është e obliguar që: gjatë tremujorit (3) të fundit të secilit vit kalendarik të përgatit dhe dorëzon në Ministrin e Ekonomisë (ME), Projekt Planin për Menaxhimin e Resurseve Minerale për vitin vijues, i cili duhet të jetë në përputhje me Strategjinë Minerare të Republikës së Kosovës. Plani i Menaxhimit të Resurseve Minerale të Republikës së Kosovës për vitin 2023, është shqyrtuar dhe miratuar më datë: 25.10.2023.
1.2.2	Hartimi i Programit të Zbatimit të Strategjisë Minerare trevjeçare (3).	2024	Pa kosto	ME, KPMM	Dokument i miratuar.	Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës, për periudhën 2012-2025.	Realizimi: zero përqind (0 %). Hartimi i Programit të Zbatimit të Strategjisë Minerare të Republikës së Kosovës për periudhën trevjeçare (3): Drafti i plotësuar me ndryshimet dhe plotësimet e kërkuara gjatë fazës së konsultimeve është dorëzuar në kabinet për konsultimet e fundit para se të procedohet më tutje sipas Udhëzimit Administrativ (UA), Qeveria e Republikës së Kosovës (QRK) Nr. 07/2018. deri tani nuk kemi marr konfirmim për të vazhduar më tutje.
1.2.3	Hartimi i Raportit Vjetor të Progresit të Programit të Zbatimit të Strategjisë Minerare (PZSM).	2024	Nuk ka kosto	ME	Raport Vjetor për vitin 2021 i përfunduar.	Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës, për periudhën 2012-2025.	Realizimi: njëqind përqind (100 %). Vazhdon monitorimi i rregullt i Zbatimit të Strategjisë Minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2012-2025. Mbi bazën e monitorimit deri në fund të tremujorit (3) të parë të vitit 2023 është hartuar dhe miratuar Raporti i Progresit për vitin 2022.
1.2.4	Promovimi i sektorit minerar.	2024	BK UIBM, KPMM	ME, UIBM, KPMM	Konferenca vjetore të realizuar për "Gjeoshkencat,	Strategjia Minerare e Republikës së	Realizimi: njëqind përqind (100 %). Sipas planifikimeve është mbajtur Konferenca e V-të

					roli i tyre në zhvillimin e qëndrueshëm”.	Kosovës, për periudhën 2012-2025.	Ndërkombëtare Multidisiplinare të Gjeoshkencave IMG2023 më datë 19 – 20 tetor 2023 në Kampusin e Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, ku Ministria e Ekonomisë/Departamenti i Minerave është bashkëorganizator i kësaj konference.
1.2.5	Mbështetja e aktiviteve të karakterit zhvillimor, në nivel vendor dhe ndërkombëtar.	2024	Pa kosto	ME ShGjK	Plotësimi i infrastrukturës për shërbime nga ShGjK-ja.	Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës, për periudhën 2012-2025.	“Grupi ndërinstitucional ka mbajtur takimin e radhës me kompaninë Terra-A SEE me datë: 27.09.2023, ku edhe janë prezantuar disa zhvillime që lidhen me procesin e implementimit të Memorandumit të Mirëkuptimit (MM). Gjithashtu, janë bërë përgatitjet dhe është konfirmuar pjesëmarrja në takimin e radhës me Shërbimin Gjeologjik Evropian, ku në mes të tjerash do të diskutohet edhe projekti i GSEU-së.”
1.2.6	Promovimi dhe pasurimi i mëtejshëm me kristale / minerale i Muzeut Shtetërorë të Kristaleve dhe Mineraleve “Trepça”.	2024	BK	ME ShGjK	Plotësimi i infrastrukturës për shërbime nga ShGjK-ja.	Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës, për periudhën 2012-2025.	Është duke u punuar në vijimësi në mirëmbajtjen e pasurimit të MShKM “Trepça”. Një ekip i MShKM-së “Trepça” ka bërë një vizitë pune në masivin Ultabazik të Goleshit. Me rastin e kësaj vizite, ka vazhduar pasurimi i Muzeut me Minerale të reja, me opalët dhe kalcedon nga Masavi Ultrabazik i Goleshit. Mineralet e pranuar nga terreni, aktualisht janë duke u trajtuar me qëllim të pastrimit dhe vendosjen në sirtar të MShKM-së “Trepça” Numri i kristaleve të gjetura janë pesë (5) të llojit opall/kalcedon me ngjyrë kafe.
1.2.7	Krijimi dhe digjitalizimi i të dhënave për rrjedhat lumore në Republikën Kosovës për periudhën 2023-2024.	2024	Pa kosto	ME ShGjK	Realizimi i punimeve fushore.	Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës, për periudhën 2012-2025.	Janë realizuar tashmë studimet përkatëse për dy (2) nga katër (4) lumenjtë e targetuar, ngase janë realizuar studimet si në vijim: 1. “Studimi kimik dhe mineralogjik i sedimenteve të lumit Lepenci”; 2. “Studimi kimik dhe mineralogjike të sedimenteve të lumit Sitnica”.

1.2.8	Monitorimi evidentimi dhe vlerësimi i ngjarjeve që lidhen me gjeorreziziqet.	2024	Pa kosto	ME ShGjK	Realizimi i punimeve fushore.	Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës, për periudhën 2012-2025.	Është bërë studimi analiza dhe përpunimi i burimeve sizmologjike (parametrave fizik dhe tërmetor), të cilat kanë ndodhur me intensitet sizmik të ulët në vendin tonë dhe disa tërmete me intensitet të lartë në rajon të ndodhura gjatë periudhës janar-tetor të vitit 2023.
1.2.9	Projekti: Plansheti Gjeologjik i Ponoshecit në shkallë 1: 25000	2024	Pa kosto	ME ShGjK	Realizimi i punimeve fushore.	Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës, për periudhën 2012-2025.	Në projektin Plansheti "Ponoshec" K34-53Dc, në shkallë 1:25 000 është duke u punuar në vazhdimësi. Gjatë periudhës për të cilën raportojmë është bërë punë analitike me të dhënat. Këto të dhëna sistematikisht janë duke i vendosur dhe plotësuar në dokumentin final që është duke u përgatitur, dhe i cili është paraparë të përfundojë gjatë këtij viti. Mostrat e marra gjatë itinerareve të fundit do të përgatiten, sistemohen dhe evidentohen dërgohen gjatë javëve në vijim për tu përpunuar në Laboratorin e "Gjeomekanikës në Mitrovicë".
1.2.10	Krijimi i kadastrit të paraqitjeve xeherore të mineralit të kromit në njësinë tektonike të Sharrit 2023-2024.	2024	Pa kosto	ME ShGjK	Realizimi i punimeve fushore.	Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës, për periudhën 2012-2025.	Vazhdim i punimeve fushore në hapësirat topografik 1:25000-Mushnikovë. Bazuar në të dhënat e marra nga terreni gjatë punës fushore brenda kësaj jave në hapësirat e planshetit topografik të Mushnikovës, është krijuar harta vëzhguese që pasqyron terrenin e mbuluar me aktivitete koreluese, e që janë: 1.Harta topografike 1:25000; 2.Harta gjeologjike etj.
<b>2</b>	<b>OBJEKTIVI STRATEGJIK: RITJA E KAPACITETEVE NJERËZORE DHE INSTITUCIONALE NË FUSHËN E SEKTORIT MINERAR</b>						
<b>2.1</b>	<b>Objektivi specifik: Zhvillimi Institucional dhe i Kapaciteteve Njerëzore</b>						
<b>Nr.</b>	Objektivat dhe veprimet	Afati i fundit	Burimi i financimit	Institucion i udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Referenca në dokumente (p.sh. PPQ, PKZMSA)	Progresi në zbatim
2.1.1	Projekti Funkcionalizimi i Labororit të Shërbimit Gjeologjik të	2024	BK	ME, ShGjK	Laboratori i funksionalizuar.	Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës,	Realizimi: njëqind përqind (100 %). Projekti Laboratori i ShGjK-së, tashmë ka përfunduar. Janë përgatitur raportet përkatëse

	Kosovës (ShGjK).					për periudhën 2012-2025.	dhe janë realizuar obligimet financiare ndaj OE-së. Së shpejti, pritet të bëhet edhe konektimi i pajisjeve përkatëse dhe funksionalizimi i plotë i pajisjeve laboratorike - me theks të veçantë të pajisjes për analiza gjeokimike - ICP-MS.
2.1.2	Kompletimi i sistemit me pajisjet e reja përkatëse për laboratorin e sizmikes:	2024	BK	ME, ShGjK	Kompletimi i laboratorit të sizmikes.	Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës, për periudhën 2012-2025.	Realizimi: njëqind përqind (100 %): 1. Dy sizmometra; - njeri periode- gjatë Model KS-2000, - tjetri periode - shkurt Model S-13, - dy regjistrues Smart 24. 2 Pajisja gjeofizike (komplet sistemi) me metoda të reflektimit dhe thyerjeve Sizmike.
<b>2.2 Objektivi specifik: Hulumtimi i Resurseve Minerale dhe Raportimi i Tyre</b>							
<b>Nr.</b>	<b>Objektivat dhe veprimet</b>	<b>Afati i fundit</b>	<b>Burimi i financimit</b>	<b>Institucion i udhëheqës dhe mbështetës</b>	<b>Produkti (Output)</b>	<b>Referenca në dokumente (p.sh. PPQ, PKZMSA)</b>	<b>Progresi në zbatim</b>
2.2.1	Ngritja e kapaciteteve për analiza gjeologjike si dhe bashkëpunimi dhe mbështetja e aktiviteteve të karakterit zhvillimor në nivel vendor dhe ndërkombëtar.	2024	Pa kosto	ME, ShGjK	Hulumtimi dhe shfrytëzimi i dokumentacionit gjeologjik historik për përpilimin e projektit nga hulumtimet e më hershme në zonat e Dragashit, Pashtrikut dhe zona e Gashit / Gjeravica.	Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës, për periudhën 2012-2025.	Realizimi: njëqind përqind (100%). Realizimi i punimeve fushore – Ka përfunduar Realizimi i punimeve laboratorike - Ka përfunduar Realizimi i punimeve kabinetike – ka përfunduar Teksti sqarues dhe krijimi i hartës përkatëse për projektin në tersi – është në fazën finale dhe pritet së shpejti të behet lidhja e dokumentit dhe protokollimi i tij.
2.2.2	Mbështetja e aktiviteteve të karakterit zhvillimor, në nivel vendor dhe nërkombëtar.	2024	Pa kosto	ME, ShGjK	Realizimi i punimeve fushore.	Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës, për periudhën 2012-2025.	Realizimi: njëqind përqind (100%). Realizimi i punimeve fushore në zonat e Dragashit, e Pashtrikut dhe zona e Gashit / Gjeravica Realizimi i punimeve laboratorike për zonat e Dragashit, e Pashtrikut dhe zona e Gashit / Gjeravica Realizimi i punimeve kabinetike për vlerësimi në tersi (për zonat e Dragashit, zonën e Pashtrikut dhe zona e Gashit / Gjeravica.



							Teksti sqarues dhe krijimi i hartës përkatëse për projektin në tersi (për zonat e Dragashit, e Pashtrikut dhe zona e Gashit / Gjeravica).
<b>3. OBJEKTIVI STRATEGJIK: ÇËSHTJET SOCIALE DHE PËRFITIMET E KOMUNITETIT</b>							
<b>3.1 Objektivi specifik Trajtimi i Çështjeve Sociale dhe Siguria në Punë</b>							
Nr.	Objektivat dhe veprimet	Afati i fundit	Burimi i financimit	Institucion i udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Referenca në dokumente (p.sh. PPQ, PKZMSA)	Progresi në zbatim
3.1.1	Organizimi i trajnimit mbi implementimin e rregullave teknike të mbrojtjes dhe sigurisë në vendin e punës.	2024	Pa kosto	ME, KPMM, “Trepça” ShA, KEK ShA	Trajnim profesional i stafit mbikëqyrës dhe punonjësve të sektorit minerar.	Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës, për periudhën 2012-2025.	Qendra e trajnimeve e cila operon në kuadër të KEK-ut, gjatë vitit, ka zhvilluar programe të ndryshme trajnimi për katërqind e tridhjetë e dy (432) persona (prej tyre pesëdhjetë (50) jashtë KEK-ut), si dhe gjithsej një mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tri (1563) ditë trajnim (prej tyre dyqind e gjashtëdhjetë e tetë (268) ditë trajnim për personat jashtë KEK-ut). Lëndë e trajnimeve ishin fusha të ndryshme duke përfshirë: sigurisë në punë, teknologji elektrike, teknologji mekanike dhe atë të saldimit, teknologjinë e xehetarisë, teknologji informative, si dhe menaxhim dhe administrim.
3.1.2	Reformimi i sistemit të vlerësimit paraprak të rrezikshmërisë.	2024	KEK	KEK	Zbatimi i ligjit, akteve nënligjore dhe rregulloreve teknike të mbrojtjes.	Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës, për periudhën 2012-2025.	Një aktivitet tjetër i rëndësishëm i përmbyllur gjatë vitit 2023 është edhe kontraktimi i shërbimit të sigurimit shëndetësor me afat për tridhjetë e gjashtë (36) muaj, duke filluar nga 01 janar 2024 me kosto 2,441,456.64 euro.
<b>4 OBJEKTIVI STRATEGJIK: PËRKUJDESJA PËR MJEDISIN</b>							
Nr.	Objektivat dhe veprimet	Afati i fundit	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Referenca në dokumente (p.sh. PPQ, PKZMSA)	Progresi në zbatim
4.1.	Mbrojtja mjedisit dhe trajtimi i çështjeve sociale.	2024	KEK	KEK	Projektet ambientale të përfunduara.	Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës, për periudhën 2012-2025.	Pastrimi i zonës së ish-Gasifikimit Transporti hidraulik i hirit. Ndërtimi i Elektrofiltrave në TC “Kosova A” Trajtimi i ish - deponisë së hirit në TC “Kosova A” – sipërfaqja, mbi dyqind e

							<p>pesëdhjetë (250) hektar. Energjia Termike – Koogjenerimi i KEK-ut, për komunitetin.</p> <p>Kanë vazhduar aktivitetet në terren rreth inspektimeve të rregullta që kanë të bëjnë me çështje mjedisore në njësi prodhuese brenda KEK-ut.</p> <p>Në ndërkohë, është angazhuar në procesin e ndjekjes së veprimeve për finalizimin e Lejes Mjedisore të Integruar (LMI). Aplikacioni është dorëzuar në fillim të muajit nëntor në MMPHI dhe është trajtuar.</p>
4.2.	Realizimi i politikave mjedisore në KEK.	2024	KEK	KEK	Projektet ambientale të përfunduara.	Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës, për periudhën 2012-2025.	<p>Ka vazhduar realizimi i aktiviteteve të planifikimit dhe përgatitjes së hapësirave në Parkun e KEK-ut, II në një sipërfaqe rreth njëzetë (20) ha, rregullimi i rrjedhave dhe pëllgjeve ujore, është shtuar fondi i drunjëve në këto hapësira.</p> <p>Janë mirëmbajtur hapësirat e TC “Kosova A” dhe Zonës së Seperimeve Kimike, janë ruajtur, si dhe mirëmbajtur plantacionet në Lismir.</p> <p>Gjatë vitit 2023 është vazhduar më shumë sukses bashkëpunimi me Zyrën e BE-së, në Kosovë, MMPHI dhe Komunën e Obiliqit lidhur me realizimin e procesit të dekomisionimit në Zonën e Seperimeve Kimike dhe ndërtimit të Magazinës për Ruajtjen e Përkohshme të Mbetjeve të Rrezikshme, si dhe bashkëpunimi me Bankën Botërore, MMPHI, Komunën e Obiliqit dhe Komunën e Fushë - Kosovës, lidhur me realizimin e projektit Parku KEK I.</p> <p>Janë iniciuar aktivitetet e prokurimit për grumbullimin, ambalazhimin dhe magazinimin e mbetjeve dhe materialeve me përmbajtje të azbestit dhe leshit mineral në hapësirat e TC “Kosova B”, TC “Kosova A” dhe DPQ, projekt ky që do të ndikoj në</p>

						<p>zvogëlimin e ndjeshëm të rrezikut për punëtorët e KEK-ut, dhe banorët e zonës.</p> <p>Është iniciuar aktiviteti i prokurimit për projektin “Trajtimi i vajrave me përmbajtje të bifenoleve të polikloruara BPK/ PCB”, që ndjeshëm do të ndikoj në zvogëlimin e rrezikut për punëtorët e KEK-ut, dhe banorët e zonës.</p> <p>Nga viti 2022 shuma e projekteve të vlerësuar në total ishte 43,103,013.00 euro dhe kishte shuma që janë shpenzuar në vlerë 257,738.03 euro, ndërsa në vitin 2023, kemi një vlerë të bartur në shumën 42,845,274.97 euro, nuk kishte shtesë dhe as rritje në provizionet aktuale, është shpenzuar shuma në vlerë 25,848.39 euro, dhe nuk kishte shuma të kthyera të pashpenzuara, apo heqje dorë nga ndonjë prej projekteve të parashikuara.</p>
--	--	--	--	--	--	---